



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 22.04.2025

Nr: 536

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË DENONCIMIN
NR. 124 ID, DATË 17.04.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE,
TË QENDRËS "QËNDRESA QYTETARE"**

Sot më datë 22.04.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

KËRKUES: Qendra "Qëndresa Qytetare"

SUBJEKT: **Z. Ervin Hoxha**
Ministër i Brendshëm

OBJEKT: 1. Konstatimin e përdorimit të burimeve publike
2. Marrjen e sanksioneve administrative bazuar në dispozitat ligjore ndaj të gjithë personave të kallëzuar, si dhe atyre që do të identifikohen gjatë hetimit administrativ

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, neni 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator

KONSTATOJ:

Qendra "Qëndresa Qytetare" më datë 17.04.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet protokollit, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 124 ID.

Data 22.04.2025

Nr: 536
Ora: 12:00



"Për fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 124 ID, datë 17.04.2025, të regjistrin të denoncimeve, të Qendrës "Qëndresa Qytetare"

Në këtë denoncim Qendra “Qëndresa Qytetare” parashtron sa vijon:

“Më datë 14.04.2025, në orën 18:24, në Rrugën ‘Haxhi Hafiz Sabri Koçi’, Njësia Administrative nr. 1, ka mbërritur Z. Ervin Hoxha, me detyrë Ministër i Brendshëm, me automjetin me targa AB942SP. Krahas funksionit të tij publik, z. Hoxha mban edhe detyrën e Drejtuesit Politik të Njesisë Administrative Nr. 1, si dhe është kandidat për deputet i Partisë Socialiste në Qarkun e Tiranës për zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025. Siç vërehet, z. Hoxha i shoqëruar në prezencën e personave të tjerë nxjerr nga makina materialet propagandistike të Partisë Socialiste.”

Nga sa më sipër çmoj se, ekzistojnë kushtet për t’u nisur hetimi administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 8, pika 3, të vendimin nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S:

1. Fillimin e procedurës administrative ndaj:
 - Z. Ervin Hoxha, Ministër i Brendshëm.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

